

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË GJIROKASTER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Gjirokastrë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2013 deri më 31.07.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.166, datë 26.12.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 766/7 datë 26.12.2015, i ka rekomanduar z. Zamira Rami, Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje:

- Shkresa e dërgimit të konkluzioneve, është e konceptuar dhe e strukturuar në kundërshtim me formatin standard, sipas Aneksit nr. 8, të Udhëzimit nr. 12, datë 05.06.2012 të Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm.

- Me përfundimin e auditimit, pas përfundimit të angazhimit, evidentimit të shkeljeve dhe konstatimeve, për çdo konstatim, nuk është proceduar me njoftim të rezultateve për titullarin e njesisë.

- Fletë-Udhëtimet e mjeteve, në të gjithë periudhën e audituar dhe për të gjitha mjetet të cilat përdoren nga Ndërmarrja Komunale, nuk plotësoheshin sipas kërkesave ligjore, si dhe në to nuk mundësohej evidentimi i punës së kryer dhe llogaritja e normave të shpenzimeve të karburanteve të harxhuara.

- Vlera e shpenzimeve materiale, për mirëmbajtjen e 6 mjeteve në shërbim të Ndërmarrjes Komunale Gjirokastrë, referuar shumave tepër të larta për mirëmbajtjen e tyre, evidenton mos respektimin e kriterëve ligjore për përdorimin me efikasitet ekonomik dhe efektivitet, të aktiveve, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe pikat 36, 37,42, 43 dhe 44 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për 5 automjete në shërbim të Ndërmarrjes Komunale, rezulton se janë të pa targa dhe dokumentet e domosdoshme ligjore, të cilat kërkohen për qarkullimin në trafikun rrugor. Përdorimi i tyre në funksion të shërbimit, nga kjo ndërmarrje, është në kundërshtim me të gjitha rregullat e parashikuara në Ligjin nr. 8378 datë 22.07.1998 të “Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 1, neni 92, neni 178, pika 1,7 dhe 8, si dhe neni 191 .

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa, për të përmirësuar korrespondencën shkresore me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm. Materialet të jenë të konceptuara dhe strukturuar sipas formatit standard, përcaktuar në Aneksin nr. 8, të Udhëzimit MF nr. 12 datë 05.06.2012 të Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

- Të nënshkruhen nga Titullari i Njesisë Qeverisjes Vendore, masat e marra sipas rekomandimeve nga Auditimi i Brendshëm, të cilat pasqyrohen në Memorandumin përkatës.

- Të plotësohen sipas kërkesave ligjore për evidentimin e punës së kryer dhe llogaritjen e normave të shpenzimeve të karburanteve të harxhuara. Fletë - udhëtimet e mjeteve, për çdo rast dhe për të gjitha mjetet të cilat përdoren nga Ndërmarrja Komunale.

- Për të 5 automjetet në shërbim të Ndërmarrjes Komunale, të cilat rezultojnë se janë të pa pajisura me targa dhe dokumentet e domosdoshme ligjore, të kryet bllokimi i tyre deri në plotësimin me dokumentet e nevojshme.

2. Gjetje: Në programimin e shpenzimeve për vitet 2013, 2014 dhe 2015, nuk janë përfshirë detyrimet afat shkurtër ndaj të tretëve, të rezultuara nga mbyllja e vitit ushtrimor, në kundërshtim me Udhëzimi nr. 2 datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, paragrafi 101.

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa, që në përgatitjen e projektbuxhetit korent dhe afatmesëm, të parashikojnë saktësisht detyrimet afatshkurta ndaj të tretëve, të cilat janë të pa likuiduara në fund të vitit ushtrimor 2015.

3. Gjetje: Bashkia Gjirokastrë nuk ka realizuar programin e investimeve në vitin 2013, me një diferencë prej -55,776 mijë lekë ose në masën 42.8%. Në vitin 2014 me diferencë prej -63,343 mijë lekë ose në masën 56.1% dhe në vitin 2015 deri më 31.07.2015 me diferencë prej -66,375 mijë lekë ose 40.9% .

Rekomandimi: Këshilli Bashkisë Gjirokastrë të analizojë shkaqet, faktorët, përgjegjësitë, për mosrealizimin e investimeve dhe të marrë masat e duhura për realizimin e tyre me cilësi dhe në afatet e caktuara në kontratat e nënshkruara me operatorët ekonomik.

4. Gjetje;Në strukturën e administratës së Bashkisë Gjirokastrë, janë konstatuar shkelje, konkretisht: në 8 raste janë emëruar punonjës me arsim të mesëm, 3 raste janë emëruar me arsim Bachelor 3 vjeçar, ndërsa vendi i punës kërkon punonjës me diplomë të integruar DIND, DND, të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 12, paragrafi i V, si dhe me lidhjen nr. 2 e 7, të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të njësive të qeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe VKM nr. 586, datë 17.07.2013.

-Klasifikimi i vendeve të punës në Drejtoritë e Bashkisë, nuk është bërë konform vendimit të KM nr. 848, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, pasi konstatohet hartimi dhe miratimi i një strukture organizative, jo në funksion të mundësive brendshme financiare të bashkisë .

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa dhe të rishikojë strukturën e administratës, duke vendosur punonjësit sipas klasave dhe kërkesave ligjore për llojin e kualifikimit arsimor të përshtatshëm me vendin e punës.

5. Gjetje:

Bashkia Gjirokastrë, nuk ka marrë masat e duhura, për arkëtimin e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore.

-Nuk është krijuar regjistri i aktiveve të qëndrueshme, ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si: data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar, etj., sipas kërkesave të Kap. III-të të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Me gjithë punën e bërë nga Bashkia, nuk janë regjistruar në postin “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të gjitha objektet dhe nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,Gjirokastrë, sipas kërkesave të ligjit.

-Pasqyrat financiare të Bashkisë Gjirokastrës, nuk paraqesin treguesit e pasqyrave financiare (bilancet) për katër institucionet, që janë pjesë e Bashkisë: Qendra Ekonomike e Arsimit, Ndërmarrja Komunale, Qendra Ekonomike e Kulturës dhe Klubi i Sportit.

Rakordimi artificial i parasë dhe rezultatit nga operacionet. Vazhdimi i praktikave të tilla të rakordimit, ndërkohë që metoda e kontabilitetit në bazë përlllogaritjeje është praktikuar në lidhje me shpenzimet, çon në regjistrime të gabuara dhe rakordime artificiale.

Shumat për t'u arkëtuar: Pasqyra e të Ardhurave janë përgatitur mbi bazën e parasë, siç kërkohet me Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Bashkia duhet të njohë plotësisht shumat për t'u arkëtuar në pasqyrën e aktiveve. Megjithatë, në Udhëzimet e dhëna nga MF, nuk specifikohet në mënyrë të qartë, se cila llogari duhet të preket në anën kreditore.

Të arkëtueshmet nga taksat: Të arkëtueshmet në lidhje me taksat dhe tarifatat lokale nuk janë regjistruar në Pasqyrat financiare për vitet 2013, 2014. Sipas Udhëzimit Nr. 14 data 28.12.2006, këto të arkëtueshme duhet të regjistrohen si të arkëtueshme në llogarinë 468 dhe si të ardhura të shtyra në anën e detyrimeve.

Zhvlerësimi i aktiveve: Nuk ka udhëzime dhe politika të kontabilitetit nga MF në lidhje me zhvlerësimin e aktiveve. Bashkia duhet të pajiset me udhëzime të qarta dhe të detajuara në lidhje me politikën e zhvlerësimit dhe trajtimin kontabël për zhvlerësimin e shumave të vjetra për t'u arkëtuar dhe aktiveve të tjera.

Provigjonet: Aktualisht nuk ka udhëzime nga MF në lidhje me njohjen, matjen dhe paraqitjen e provigjoneve. Bashkia duhet të marrë nga Ministria e Financave udhëzime të hollësishme në lidhje me trajtimin kontabël të provigjoneve, duke përfshirë dhe procedurat që ato duhet të ndjekin.

Mungesa e një formati të njëtrajtshëm të buxhetit: Nuk janë plotësuar me një format të pranuar gjerësisht për buxhetin, por bashkia ka përgatitur buxhetin në një format të pakufizuar. Ky format nuk është i krahasueshëm me formatin e raportimit të pasqyrave financiare, duke krijuar kështu vështirësi për të ndjekur performancën aktuale kundrejt asaj të buxhetuar në mënyrë të vazhdueshme dhe në fund të vitit.

Pasqyrat financiare të viteve 2013, 2014, nuk janë mbështetur me të dhëna të plota dhe gjithë përfshirëse.

Mungesë e një regjistri të duhur aktivesh:

- nuk ka llogaritur amortizimin për çdo aktiv më vete siç kërkohet në Udhëzimin nr. 14 datë, 28.12.2006. Në fakt, amortizimi është llogaritur në bazë të vlerës së kostove për çdo grup të aktiveve (p.sh Ndërtesa dhe ndërtimet)

- nuk është marrë akoma Vendimi përfundimtar i Këshillit të Ministrave mbi transferimin e aktiveve, pronësia e të cilave duhet ti kalojë Bashkisë Gjirokastrë, me pas e vlerësohen dhe te regjistrohen në Pasqyrat financiare të saj, kjo dhe në zbatim të reformës administrative.

-nuk ka ndërmarrë veprime në lidhje inventarizimin fizik të aktiveve dhe të përpilojë një regjistër gjithëpërfshirës të aktiveve fikse, duke përfshirë dhe bashkimin me komunat e tjera sipas ndarjes territoriale.

Të pagueshmet nuk regjistrohen në pasqyrat financiare: Bazuar në të dhënat për të pagueshmet më 31.12.2013 dhe 31.12.2014, është konstatuar se të pagueshmet nuk janë regjistruar në pasqyrat financiare të bashkisë.

Ka mungesë informacioni për balancat e mbetura të të arkëtueshme:

Nuk ka qasje në sistemin e faturimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizimeve Gjirokastrë sh.a, përmes së cilit grumbullon një pjesë të konsiderueshme të taksave dhe tarifave. Bashkia nuk

ka informacion për balancat e papaguara të familjeve dhe bizneseve që paguajnë përmes kësaj kompanie për furnizim me ujë.

Për më shumë, balancat e taksave të pa paguara nga bizneset, janë përditësuar rregullisht, por nuk janë kontabilizuar dhe hedhur në Pasqyrat Financiare, duke penguar procesin e mbledhjes së këtyre taksave mund të pengohet.

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër nëpërmjet Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Pronave, të marrë masat e nevojshme dhe:

-Të përgatisë një dokument ku të përshkruajë organizmin dhe procedurat kontabël, i cili është i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së auditimit.

-Të saktësojë sipas analizave, aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe aktivet qarkulluese, kjo në mbështetje të inventarizimit fizik, si dhe të rivlerësojë aktivet e qëndrueshme sipas kërkesave ligjore.

-Të krijojë regjistrin e aktiveve të qëndrueshme, ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si: data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar, etj.

- Të llogarisë amortizimin për çdo aktiv, duke shmangur parregullsitë e llogaritjeve në grup njësi dhe të bëhet pasqyrimi në dokumentet e nevojshme kontabël.

- Të regjistrojë në pasqyrat financiare “Të pagueshmet” bazuar në të dhënat për tu paguar, që i përkasin periudhave datë 31.12.2013 dhe 31.12.2014 e në vijim.

- Të sigurohet akses në sistemin e faturimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizimeve Gjirokastër sh.a, përmes së cilës Bashkia arkëton një pjesë të konsiderueshme të taksave dhe tarifave.

-Të sigurohet informacioni për balancat e papaguara të familjeve dhe bizneseve që paguajnë përmes “Ujësjiellës-Kanalizimeve Gjirokastër” sh.a.

-Të kontabilizohen dhe hidhen në Pasqyrat Financiare balancat e taksave të pa paguara nga bizneset, pasi nga mos regjistrimi, procesi i mbledhjes së këtyre taksave mund të pengohet.

6. Gjetje: Në përcaktimet dhe miratimet e kritereve të veçanta të kualifikimit, ka mangësi, pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomike më të favorshme, nuk i plotësojnë kushtet e nenit 46, pika 1, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për arsye se, nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës; nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderave .

-Kriteret e përdorura për vlerësimin e ofertave nuk janë specifikuar në mënyrë të qartë nga ana e Njesisë së Prokurimit, për rrjedhojë lejojnë Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, t’i interpretojë ato në mënyra të ndryshme në procedura të ndryshme madje në disa raste me impakt financiar në dëm të autoritetit kontraktor **në vlerën 12,195,169 lekë**, nga e cila: vlera 11,101,202 lekë në **8 kontrata** me vlerën 76,679,357 lekë në vitin 2014 dhe 1,093,967 lekë në **11 kontrata** me vlerë 30,034,950 lekë në vitin 2015.

-Dokumentet e kërkuara për të vërtetuar realizimin e kritereve të kualifikimit, nuk kanë argumentim me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, kjo në kundërshtim me nenet 26-28 të Seksioni II Informacione të veçanta për kontratat”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe pikat 1 dhe 3, të nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP) dhe në këto rregulla. Kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke

paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa dhe të forcojë sistemin e kontrollit të brendshëm, në lidhje me procedurat e planifikimit dhe prokurimit. Konkretisht:

Për llogaritjen dhe argumentimin e fondit limit, në hartimin dhe vlerësimin e specifikimeve teknike, në hartimin e Projektit të Zbatimit, Raportit Teknik, Specifikimet dhe Preventivin, në përgatitjen, miratimin dhe hedhjen në sistem të dokumenteve të tenderit në mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës, kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve, mallrave dhe shërbimeve, likuidimin e transaksioneve dhe zbatimin e detyrimeve kontraktuale.

7. Gjetje: Sipas transaksionit nr. 189, datë 06.6.2014, në vlerën 4,400 mijë lekë, **rezulton se**, më datë 19.05.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me vendimin gjyqësor 201(21-2014-607) datë 19.05.2014, ka vendosur detyrimin e bashkisë Gjirokastrë të shlyejë shumën prej 4.4 milionë lekë për zënien e tokës në mënyrë të pa drejtë nga ana e saj. Në këtë transaksion konstatojmë se, bashkia nuk ka zbatuar ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik” si dhe mos ankimim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në shkallët e tjera të gjyqësorit, duke shkaktuar një shpenzim të panevojshëm këtij institucioni në vlerën **prej 4, 400** mijë lekë. Bashkia Gjirokastrë edhe mbas kësaj pagese, nuk është pronare e kësaj pasurie të ndodhur në lagjen “Pllakë” (Punëtore) Gjirokastrë me sipërfaqe 470 m², sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore nr. 140, datë 21.02.2000 .

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa dhe të analizojë me përgjegjësi statusin juridik dhe marrëdhënien juridike, duke nxjerrë përgjegjësitë për zënien e tokës, në kundërshtim me ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, pasi për shkak të këtyre veprimeve, institucioni është detyruar të ekzekutojë vendimin gjyqësor duke paguar shumën 4,400 mijë lekë.

8. Gjetje nga auditimi: Në *35 procedura prokurimi*, shërbimi i hartimit të projektit të zbatimit nuk është prokuruar, sipas nenit 35 “Konkurs projektimi”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 38 “Konkursi i projektimit”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe DST, pasi autoriteti kontraktor në përcaktimin e fituesit, nuk ka zbatuar procedurat e parashikuara në këtë ligj .

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë në të gjitha rastet e hartimit të projektit të zbatimit, duhet të organizojë konkurs projektimi, duke iu nënshtruar procedurave të prokurimit publik për shërbim konsulence ose konkurs projektimi konform dispozitave të fushës së prokurimeve publike.

9. Gjetje nga auditimi: Projekti Zbatimit, Raporti Teknik, Specifikimet dhe Preventivi të hartuara nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve dhe projektuesit, nuk janë pajisur me licencë profesionale në fushën e projektimit, në kundërshtim me nenin 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Rekomandimi; Bashkia Gjirokastrë të marrë masa që të gjitha Projektet e Zbatimit, Raporti Teknik, Specifikimet dhe Preventivi, duhet të hartohen nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse konform nenit 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

10. Gjetje: Në 12 objekte zbatimi titullari i autoritetit kontraktor, nuk ka zhvilluar procedurë prokurimi për mbikëqyrje punimesh, në kundërshtim me nenet 1, 2, 4 dhe 29 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, për arsye se autoriteti kontraktor, nuk ka zbatuar procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër të marrë masa për shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve të zbatimit, duke kryer procedurat e prokurimit publik, për kontrata-shërbimesh sipas dispozitave ligjore.

11. Gjetje: Titullari i autoritetit kontraktor ka emëruar tre inxhinierë, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për punimet civile, në kundërshtim me neni 7, ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, për arsye se mbikëqyrësit, nuk kanë kategorinë përkatëse për mbikëqyrje punimesh të përcaktuar nga autoriteti përkatës shtetëror.

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër të marrë masa që shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve të zbatimit, të kryhet nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse.

12. Gjetje: Në dosjet e arkivuara me status të përfunduar janë konstatuar raste që arkivimi i kontratës së lidhur, është bërë me vonesë nga botimi i kontratës së lidhur, duke mos zbatuar afatin e përcaktuar të arkivimit të procedurës brenda 1 ditë pune nga mbyllja e fazës së njoftimit të kontratës së lidhur, e përcaktuar kjo në Urdhrin nr. 57, dt. 12.06.2014 dhe Udhëzimin e Agjencia e prokurimit publik nr. 3, datë 01.06.2010 "Për shpalljen e njoftimit të kontratës, njoftimit të fituesit dhe njoftimit të kontratës së lidhur në sistemin e prokurimit elektronik" i ndryshuar, me udhëzimin nr. 2, datë 03.04.2014.

Rekomandimi: Drejtoria e Prokurimeve të marrë masa dhe të bëjë mbylljen e arkivimeve të kontratave për procedurat e prokurimeve të përfunduara brenda afatit, nga mbyllja e fazës së njoftimit të kontratës së lidhur, duke siguruar që arkivimi i kontratës të rezultojë me status të përfunduar.

13. Gjetje nga auditimi: Në mbështetje të Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 57 datë 11.6.2014, pika 3, në të cilën përcaktohet që: “Në referim të gjurmës standarde të auditimit, Titullari i çdo njësie publike të qeverisjes së përgjithshme të hartojë gjurmën e detajuar të auditimit për njësitë që drejtojnë”, duhet të ishte hartuar e miratuar gjurma e detajuar e auditimit, e cila do të përbëjë një bazë të hapave dhe procedurave që duhet të ndjekin të gjitha strukturat e bashkisë në këtë proces .

Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe Drejtoria e Prokurimeve të marrin masa, për hartimin e gjurmëve të detajuara të auditimit për prokurimet publike që do të kryejnë dhe ta paraqesë tek nëpunësi autorizues për miratim.

14. Gjetje: Gjatë zbatimit të punimeve për ndërtimin e objektit “Projekte në Parkun e Viroit: Sistemim i Parkut të Viroit, Rikonstruksion i rrugës në Parkun e Viroit, Ndriçim i trotuarit nga ana e qytetit”, Bashkia Gjirokastër, **me kontraktor** bashkimi i operatorëve ekonomik “A- A”&”E.C.Company”, nuk është siguruar cilësia sipas standardeve dhe kërkesave teknike për 4 zëra punimi të ndërtimit, duke rezultuar me dëmtim të objektit.

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa dhe të ndjekë eliminimin e defekteve të konstatuara për 4 zëra të punimeve të ndërtimit, nga bashkimi i operatorëve ekonomik “A- A” sh.p.k.& ”E.Cons”, duke vlerësuar me përgjegjësi standardet e arritura lidhur me cilësinë e realizimit të punimeve të cituara më sipër.

15. Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të punimeve për ndërtimin e objektit “Terrene sportive në 4 shkolla në Gjirokastrë (shkolla “Siri Saplo, shkolla “Thoma Papa, shkolla “Pandeli Sotiri, Shkolla “Çajupi””, Bashkia Gjirokastrë me kontraktor bashkimi i operatorëve ekonomik “F.” sh.p.k. & ”E.C”, nuk është siguar cilësia sipas standardeve dhe kërkesave teknike për 3 zëra punimi të ndërtimit, duke rezultuar me dëmtim të objektit, në kundërshtim me pikën 4, të Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001” Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar dhe me në pikën 9, të Udhëzimit nr. 1, datë 22.02.2005 ”Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001” Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar” .

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa dhe të ndjekë eliminimin e defekteve të konstatuara për 4 zëra të punimeve të ndërtimit, nga bashkimi i operatorëve ekonomik “F...” sh.p.k. & ”E.C...”, duke vlerësuar me përgjegjësi standardet e arritura lidhur me cilësinë e realizimit.

16. Gjetje nga auditimi: Në treguesit e programimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, sipas zërave të përcaktuara në programet përkatëse, për periudhën e auditimit, rezultoi një diferencë në vlerë **68,859 mijë lekë**, e cila ka ardhur kryesisht nga mos funksionimi i plotë i funksioneve në përbërje të Drejtorisë së të Ardhurave të Tatim-Taksave Vendore të Bashkisë Gjirokastrë, si dhe nga mungesa e bashkëpunimit ndërmjet kësaj Drejtorie me Policinë Bashkiake. Këto veprime bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 2, pika 1 dhe 5, neni 16 “Të ardhurat e veta të komunës dhe të bashkisë”, gjerat a, b, c dhe ç, kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, “Zbatimi i Sistemit Tatimor në Republikën e Shqipërisë”, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7, si dhe kërkesat e udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”, i ndryshuar.

16.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave të Tatim-Taksave Vendore, të marrë masa konkrete për të përmirësuar funksionimin e pozicioneve të veçanta të punës brenda Drejtorisë dhe forcimin e bashkëpunimit midis tyre, me qëllim rritjen e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të punës kontrolluese nga specialistët e kontrollit në terren dhe specialistët të menaxhimit të borxhit. Për këtë qëllim të përgatiten programe pune mujore, tremujore dhe vjetore, të miratuara nga Titullari, me qëllim evidentimin e riskut, në mënyrë të dokumentuar gjatë kontrolleve të programuara, për mbledhjen e të ardhurave dhe menaxhimin e borxhit.

17. Gjetje: Bashkia Gjirokastrë ka kontraktuar me marrëveshje për mbledhjen e të ardhurave nga taksa e pasurisë, tarifa e pastrimit dhe heqjes së mbeturinave, ndriçimit dhe gjelbërimit, me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Gjirokastrë, bazuar në numrin e familjeve që kanë të regjistruar një sahat uji. Ky numër familjesh në raport me numrin e familjeve që gjenden në Zyrën e Gjendjes Civile të Bashkisë është më i vogël, pra nuk kemi një numër të saktë të familjeve rezidente në qytetin e Gjirokastrës .

Rekomandimi: Drejtorja e të Ardhurave të Tatim-Taksave Vendore pranë Bashkisë Gjirokastrë, të marrë masa për vlerësimin e plotë të numrit të familjeve që banojnë, nëpërmjet regjistrimit të Gjendjes Civile, dhe subjektet e personat fizik që zotërojnë prona në juridiksionin e bashkisë dhe të bëjnë regjistrimin e tyre në një “database” të veçantë e të aksesueshëm. Në këtë regjistër të përvitësohen shtesat dhe pakësimet vjetore të numrit të

familjeve, që do të shërbejë si një bazë e rëndësishme, për të gjitha programimet e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, që kanë për bazë llogaritje, numrin e familjeve.

18. Gjetje nga auditimi: Subjektet me detyrime debitore të papaguara për taksat dhe tarifat nuk janë ndëshkuar me sanksione në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” .

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave të Tatim-Taksave Vendore pranë Bashkisë Gjirokastrë, të marrë masa që të gjithë subjektet debitorë të trajtohen me masa shtrënguese konkrete, me qëllim rikuperimin e borxhit, për të gjithë subjektet debitore të vitit 2013-2014, duke vendosur dhe sekuestro ekzekutive, deri në konfiskimin e pasurisë.

19. Gjetje nga auditimi: Detyrimet debitore (borxhit), kanë ardhur çdo vit në rritje, të cilat më datë 31.07.2015 janë në vlerën 29,349 mijë lekë, për arsye se masat shtrënguese, përfshirë sekuestrimi dhe konfiskimin e mallrave, pothuajse nuk janë zbatuar, ky veprim bie ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 88, autoriteti dhe kompetencat për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar .

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave të Tatim-Taksave Vendore, Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa me qëllim rikuperimin e vazhdueshëm të detyrimeve debitorë gjendje, e cila më datë 31.07.2015, rezulton në *vlerën 29,349 mijë lekë*.

20. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e të Ardhurave të Tatim-Taksave Vendore, Bashkia Gjirokastrë, nuk disponon regjistra analitike, ku të ketë regjistruar tatimpaguesit debitorë (borxhit), për subjektet fizikë dhe juridikë në juridiksionin e Bashkisë, objekt i pagesës së taksave dhe tarifave vendore, e regjistruar sipas viteve të krijimit borxhit”, të dhënat e administruara në mënyrë elektronike, nuk janë të arkivuara me inventarë të rregullt në arkivin e bashkisë .

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave të Tatim-Taksave Vendore pranë Bashkisë Gjirokastrë, krahas mbajtjes dhe administrimit të të dhënave në sistem elektronik, të përgatisë regjistrin e tatimpaguesve debitor (borxhit) në mënyrë analitike dhe për të gjitha subjektet fizike dhe juridike, objekte të pagesës së taksave dhe tarifave vendore. Në këtë të regjistrohen: NIPT-i, lloji i aktivitetit dhe adresa përkatëse, të pasqyrohen dhe detyrimet vjetore sipas llojit të taksës e tarifës, afatet e pagesës së detyrimit të përputhen me afatet e përcaktuar me ligj, duke regjistruar numrin dhe datën e pagesës. Në fund të çdo viti është e domosdoshme që regjistri të printohet dhe të arkivohet në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

21. Gjetje: Drejtoria e Planifikimit Urban, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve, nuk ka zbatuar VKM nr. 480, datë 22.6.2011 “Për miratimin e rregullores model të planifikimit” e ndryshuar , neni 10, pika 11 e cila përcakton se infrastruktura e nevojshme që mundëson funksionimin e një zhvillimi të ri, të lidhur me rrjetet ekzistuese të infrastrukturave, realizohet nga zhvilluesi dhe leja e përdorimit jepet vetëm, pasi kjo infrastrukturë regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, sipas përcaktimit të legjislationit në fuqi” dhe nuk ka patur certifikatë apo vërtetim pronësor të lëshuar nga ZVRPP Gjirokastrë .

21.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë dhe Drejtoria e Planifikimit Urban, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve për çdo rast, përpara lëshimit të lejes së përdorimit të shqyrtojë e vlerësojë nëse nga subjekti është përmbushur kriteri ligjor lidhur me regjistrimin e infrastrukturës në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme të ZVRPP Gjirokastrë.

22. Gjetje: Drejtoria e Planifikimit Urban, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve, para lëshimit të lejeve të përdorimit nuk ka kërkuar nga çdo subjekt ndërtues plotësimin me

dokumentacion të dosjes së lejes së zhvillimit të miratuar më parë me vendim të KRRT Bashkia Gjirokastrë, vendime të marra sipas ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” dhe VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e Rregullores së Urbanistikës”.

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria e Planifikimit Urban, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve, për çdo rast, përpara lëshimit të lejes së përdorimit të shqyrtojë e të vlerësojë, nëse subjekti ka të plotësuar të gjithë dokumentacionin e praktikës së lejes së përdorimit, kjo si për dosjet e trajtuar me mangësi në këtë raport auditimi ashtu dhe për ato që paraqiten në të ardhmen.

23. Gjetje: Drejtoria e Planifikimit Urban, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve,, para lëshimit të lejeve të përdorimit nuk është kërkuar nga Inspektorati Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor pranë Bashkisë Gjirokastrë, nëse subjekti ndërtues ka apo jo detyrime të pashlyera, apo nëse ndaj tij është proceduar me sanksione të cilat janë në proces apo ende të përfunduara .

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit Urban, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve, për çdo rast përpara lëshimit të lejes së përdorimit, të kërkojë zyrtarisht nga IMKTV Bashkia Gjirokastrë aktet e mbajtura me subjektin përkatës si dhe nëse rezulton se ka detyrime të pashlyera ndaj kësaj strukture.

24. Gjetje: Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria e Planifikimit Urban Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve, nuk ka hartuar regjistrin e planifikimit të territorit, për territorin që administrojnë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 ‘Për planifikimin e territorit’ dhe Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” .

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria e Planifikimit Urban, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve, të regjistrojë të dhëna përkatëse, duke krijuar regjistrin e planifikimit të territorit, për territorin që administron.

25. Gjetje: Bashkia Gjirokastrë nuk ka miratuar në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT) në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) Planin e Detajuar Vendor dhe Planit të Përgjithshëm Vendor, në kundërshtim me nenin 13 “Funksionet, kompetencat e përgjegjësitë e bashkisë në planifikimin vendor” të ligjit nr. 10 119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, nenet 15, 20 dhe 22 të ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” .

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit Urban, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve, të marrë masa për përshtatjen e planit vendor, që ka mbetur në proces miratimi, me rregulloret uniforme dhe dispozitat e këtij ligji, për të bërë të mundur miratimin e planit të përgjithshëm vendor (PPV) ose planin e përdorimit të tokës (PPT).

26. Gjetje:

-Nuk janë kryer aktet e kontrollit nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve, për vitet 2013, 2014 dhe 01.01.2015-31.07.2015, që të vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, sipas fazave të përcaktuara në rregulloret e kontrollit të zhvillimit për: themelin, karabinanë, punimet mekanike, hidraulike, të izolimit, rifiniturave dhe të sistemimeve të jashtme, në kundërshtim me, seksioni VI, neni 79 “Leja e përdorimit” e ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 ‘Për planifikimin e territorit’ dhe pikën 2, neni 38, të VKM Nr. 502, datë 13.07.2011 për “Miratimin e rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit”.

- Drejtoria e Planifikimit Urban, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve dhe Inspektorati Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor, nuk kanë kontrolluar praninë e mbikëqyrësit të

punimeve në objekt dhe në rast konstatimi të mungesës së tij të nxjerrin vendim për pezullimin e punimeve deri në emërimin dhe praninë e tij në objekt, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011 Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

-Në 52 raste të dhënies së certifikatës së përdorimit për periudhën 01.07.2013-31.07.2015, nuk dokumentohet pronësia mbi truallin dhe pagesa përfundimtare e sheshit të ndërtimit.

- Në dosjen e dhënies së lejes së përdorimit me Nr. Prot., 3798/1, datë 21.01.2015 me objekt “Magazinë e banesë”, 1kt, u konstatua se, planimetria e sheshit ndërtimit të objektit “Magazinë e banesë (zona e Ish SMT) me sipërfaqe të objektit 246 m2 në pronë publike dhe 540 m2 në pronë private, është në kundërshtim me vendim të KRRT nr. 13 datë 08.04.1998 dhe Vendimi i këshillit bashkisë nr. 41, datë 03.06.1998 në të cilin sipërfaqja e sheshit është 246 m2.

-Në të gjitha procedurat për dhënien e lejes së përdorimit për periudhën 2013, 2014 dhe Janar-Gusht 2015, nuk administrohet në dosje dokumentacioni i kërkuar me udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Drejtorja e Planifikimit Urban, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve dhe Inspektorati Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor të marrin masa, që për të gjitha punimet e ndërtimit, ndërtimet dhe sipërmarrjet, të zbatohen me korrektësi procedurat e mbikëqyrjes dhe kontrollit të kryerjes së punimeve, duke marrë masa ndëshkuese për ato persona e subjekte që nuk i zbatojnë kërkesat ligjore.

27. Gjetje: Në 52 raste kërkuar të certifikatës së përdorimit nuk ka paraqitur vërtetim për përmbushjen e detyrimeve tatimore, në të cilin DRT vërteton se Tatimpaguesi i regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore me NIPT me aktivitet kryesor në fushën e ndërtimit, rezulton i rregullt në zbatimin e legjislacionit tatimor dhe nuk ka detyrime tatimore të papaguara në buxhetin e shtetit, deri në datën e lëshimit të këtij vërtetimi për objektin: Lloji i objektit, vendndodhja dhe numri i lejes, para kërkesës së subjektit për pajisje me leje përdorimi .

Rekomandimi: Investitori të paraqesë vërtetim për përmbushjen e detyrimeve tatimore, në të cilin DRT vërteton se, Tatimpaguesi i regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore me NIPT me aktivitet kryesor në fushën e ndërtimit, rezulton i rregullt në zbatimin e legjislacionit tatimor dhe nuk ka detyrime tatimore të papaguara në buxhetin e shtetit, para kërkesës së subjektit për pajisje me leje përdorimi.

28. Gjetje: Në 52 raste të dhënies së certifikatës së përdorimit për periudhën 01.07.2013-31.07.2015, nuk dokumentohet pronësia mbi truallin dhe pagesa përfundimtare e sheshit të ndërtimit.

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, Drejtorja e Planifikimit Urban, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve, në bashkëpunim me ZVRPP të rishikojë pronësinë mbi truallin dhe pagesa përfundimtare të truallit në rastet ku leja e sheshit, është dhënë në pronë publike , kjo si për dosjet e trajtuar me mangësi në këtë projekt raport auditimi ashtu dhe për ato që paraqiten në të ardhmen.

29. Gjetje: Bashkia Gjirokastrë nuk ka miratuar në Këshillin e Ministrave listën përfundimtare të pjeshme ose tërësore të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat transferohen në pronësi dhe në përdorim të saj sipas propozimeve të këshillit vendor, pas shqyrtimit nga Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronës Publike (AITPP) të

vërejtjeve që kanë për pronat e miratuara në listat paraprake dhe bazuar në informacionin përfundimtar, përfshirë dhe kushtet apo kufizimet që u vihen, përkatësisht, për secilën pronë. -Veç kësaj Bashkia Gjirokastrë, nuk ka kryer regjistrimin e tyre në përputhje me ligjin përkatës. Kështu, për pronat, që më parë kanë qenë të regjistruara si pronë shtetërore, do të bëhet ndryshimi i pronarit. Për pronat, që nuk janë regjistruar ende, bëhet regjistrimi sipas procedurave standarde të regjistrimit nën emrin e bashkisë, qarkut. Për këtë qëllim është e nevojshme, që për të gjitha pronat, të përgatiten planimetritë dhe plan vendosjet e tyre, të cilat do të regjistrohen sipas VKM-së. Mangësi këto ardhur dhe nga pengimi i bërë nga Ministria e Brendshme për shkak të Reformës Administrative .

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të hartojë program pune për miratimin në KM të listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bazuar në inventarin e miratuar nga këshilli vendor i bashkisë, të listës paraprake të pjesshme apo tërësore paraprake, të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat rekomandohen për transferim në pronësi dhe në përdorim të komunës. Këto regjistrime do të bëhen për listën përfundimtare të pjesshme ose tërësore të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat transferohen në pronësi dhe në përdorim të bashkisë sipas propozimeve të këshillit vendor, pas shqyrtimit nga Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronës Publike (AITPP).

30. Gjetje: Bashkia Gjirokastrë nuk ka hartuar plan menaxhimi e mbarështimi në pyje kullota livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve drusore, kullosore, produkteve dytësore etj, për krijimin e të ardhurave dytësore të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve për periudhën 2013 –2015, kjo në kundërshtim me Vendimin e KM nr. 22, datë 9.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të Kriterëve të Administrimit të Pyllit Komunal”, pikat 3, 4 e në vijim. Vetëm nga kapaciteti i kullotave dimërore prej mbi 2185 krerë Bashkisë Gjirokastrë i janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën **2,372,000 lekë** për periudhën 01.07.2013- 31.07.2015 e llogaritur sipas tarifave të VKM nr. 632, datë 11.06.2009 “Për miratimin e Tarifave të Përdorimit të Kullotave dhe Livadheve për Kullotje dhe Kositje”.

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa për hartimin e planit të menaxhimit dhe mbarështimit në pyje, kullota, livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, vjeljen e gjahut dhe të shërbimeve çlodhëse, dhënien me qira të pronave të veta etj, si dhe krijimin e të ardhurave dytësore, të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve.

31. Gjetje: Në 80 dosje të dhënës së aseteve me qira nuk ndodhen dokumentet si më poshtë vijon:

- Procesverbali i marrjes në dorëzim të ambientit;
- Kërkesa e qiramarrësit;- Certifikata e regjistrimit, propozimi i institucionit shtetëror për dhënien me qira ose enfiteoz t objektit, i cili përmban edhe propozimin për veprimtarinë, që mund t ushtrohet n objekt;
- Vendimi i organit drejtues të apo institucionit;
- Miratimi i organit të varësisë administrative;
- Vlera dysheme e detyrimit mujor;
- Vlera kontabël e objektit, sipas llogarive financiare në fund të vitit pararendës;
- Lista e makinerive, t pajisjeve, linjave teknologjike, galerive minerare, depozitave etj, q do t jepen me qira ose enfiteoz ;

-Konfirmimi nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për pronësinë shtet të objektit dhe truallit, si dhe nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për vendimet e dhëna prej saj për njohjen apo kthimin e pronës;

-Plan biznesi i hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë plani i punësimit, plani i investimeve dhe treguesit, që do të realizohen; -Oferta për tarifën mujore të qirasë;

-Certifikata e regjistrimit të subjektit në QKR ose vendimi i regjistrimit në gjykatë; NUIS-i dhe vërtetimi nga dega e tatimeve për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore;

-Vërtetimet nga institucionet përkatëse se subjekti nuk është në ndjekje penale dhe se nuk ka proces gjyqësor lidhur me veprimtarinë, dokumentacion që duhet të paraqesë subjekti i interesuar.

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa në të ardhmen për plotësimin e dosjeve të kontratave me dokumentacionin përkatës ligjor, para nënshkrimit të kontratës me subjektet të cilat do të marrin me qira hapësira nën administrim të saj.

32. Gjetje: Sektori i Pronave për të njëjtin hark kohor prej datës 01.01.2014-31.12.2014 dhe 01.01.2015 e në vazhdim ka lidhur në total 15 kontrata qiraje (objekte) nga të cilat për vitin 2014 janë lidhur 9 kontrata, ku 3 prej tyre janë lidhur me çmim 250l/m², ndërsa 6 kontratat e tjera janë lidhur me çmim 150l/ m², çka nënkupton se disa subjekte kanë patur diferencime. Për vitin ushtrimor 2015 janë lidhur 6 kontrata ku 5 prej tyre janë lidhur me çmim 150 l/ m², ndërsa 1 kontratë është lidhur me 250 l/ m², duke shkaktuar të ardhura të munguara **në vlerën 515,582 lekë.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me germen (e) të nenit 32 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit komunal ose bashkiak”, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, i cili shprehet se: “Këshilli komunal ose bashkiak miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve”.

Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë të analizojë e të nxjerrë përgjegjësinë për aplikime të diferencuara të tarifës së qirasë për m², nga 150 lekë/ m², deri në 250 lekë për m², në të gjitha kontratat e nënshkruara për vitet 2013, 2014 dhe 01.01.2015-31.07.2015 e në vijim, duke evidentuar diferencat dhe kërkuar arkëtimin e tyre.

34. Gjetje: Kontratat për dhënien e objekteve me qira, nuk janë miratuar në Këshillin e Bashkisë, veprim ky në kundërshtim me germen “e” të nenit 32, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.3.2004, ku parashikohet se: Këshilli i Bashkisë miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.

Rekomandimi:

-Bashkia Gjirokastrë të rishikojë e rivlerësojë sipas akteve nënligjore në fuqi kontratat e mësipërme dhe ti paraqes për miratim në Këshillin Bashkisë dhe të kërkojë arkëtimin e vlerave financiare që do të rezultojnë nga rivlerësimi.

-Të gjitha kontratat që do të nënshkruhen për tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve, të miratohen në Këshillin Bashkisë.

35. Gjetje: Inspektori i IMKTV, nuk ka arsimin e duhur pasi formimi i tij profesional është Ekonomiks çka është në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 9870, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar.

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër të marrë masa që punonjësit e Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor, të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 11, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

36. Gjetje:Në 21 raste vendimet për prishje objekti, për periudhën 2013-2015, nuk janë shoqëruar me gjobat përkatëse dhe nuk janë marrë masa për kallëzim penal, në kundërshtim me nenin 5/b dhe 5/dh të ligjit nr. 9780 “Për Inspektimin e ndërtimit”, dhe me pikën 8, të V.K.M nr. 862, datë 04.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtarë e ai vendor” .

Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor të marrë masa, për të gjitha rastet kur subjektet ndërtuese nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore në fushën e ndërtimit:

-Të vendosë gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

-Të paraqesë pranë organeve përkatëse kërkesë për heqje licence profesionale, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit.

-Të vendosë prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm.

-Për përgatitjen dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm sipas kërkesave ligjore, për shkelje të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrolleve në subjekte, për ti paraqitur ato para organeve përgjegjëse, sipas nevojës.

37. Gjetje:

- Referuar dokumentacionit të dosjeve personale për punonjësit efektiv në Policinë Bashkiake, për periudhën objekt auditimi, nuk janë zbatuar kriteret e nenit 3 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, i azhurnuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998, “Për Organizimin e Funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës”, ku cilësohet shprehimisht se “Kryeinspektori i Rrethit për Policinë e Bashkisë dhe të Komunës duhet të jetë i diplomuar në Akademinë e Policisë”.

- Nuk ka gjetur zbatim pika 7 e nenit 11, e Urdhrit të përbashkët të dy dikastereve për të gjithë personelin, pasi nuk janë lidhur kontratat e punës mbi 3 vjeçare, por vetëm me dy punonjës janë lidhur kontrata pune me afat 1 vjeçar.

- Siç rezulton nga auditimi i dokumentacionit, për të gjithë periudhën e audituar, procesi i rekrutimit të punonjësve të policisë bashkiake, nuk është zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, pasi nuk është krijuar Komisioni i Posaçëm .

Rekomandimi:Të plotësohet dokumentacioni në dosjet personale për punonjësit efektiv në Policinë Bashkiake, në zbatim të kriterëve të përcaktuara dhe të bëhet përzgjedhja e tyre sipas procedurave ligjore në fuqi, duke nënshkruar kontratat e punës me afat mbi 3vjet.

37. Gjetje nga auditimi: Në 18 raste me sipërfaqe 9800 m², gjatë periudhës 1998-2002, janë shitur troje nga Bashkia Gjirokastër, në kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, nenin 3 ku cilësohet se, derisa të përfundojë kompesimi fizik i ish-pronarëve, kalimi i trojeve të lira nga pronë shtetërore në pronë private bëhet vetëm në rastet e tjera paarshikuara nga ky ligj .

Rekomandimi:

a-Të merren masa nga titullari i Bashkisë për anulimin, revokimin apo shfuqizimin e të gjitha kontratave të lidhura për shitje trualli dhe të ndalohet lidhja e kontratave të mëtejshme nga Bashkia Gjirokastër si palë shitëse, pa pasur titull ligjor ku të rezultojë pronare sipas ligjit.

b- Bashkia Gjirokastër të marrë masa dhe në bashkëpunim me Regjistruesin e ZVRPP Gjirokastër, mbështetur në nenin 44, germa “b” e “c” e ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” i ndryshuar, **të nxjerrë urdhër kufizimi**, për të gjithë zonën kadastrale 8541, në të cilën janë evidentuar pasuri të regjistruara në hartë (me të kuqe), me numra pasurie të veçanta, që në realitet janë troje bosh (pa ndërtime), të shitura nga Bashkia Gjirokastër, sipas nomenklaturës së hartës, si më poshtë:

- Në hartën me **nomenklaturë GJ; E-7**, rezultojnë këto pasuri si troje bosh, të shitura nga Bashkia Gjirokastër.

NR.	Pasuria nr,	Sipërfaqe m ² .
1	19/22	500
2	19/24	400
3	22/23	500
4	19/28	400
5	19/18	400
6	19/21	400
7	19/35	500
8	19/33	2000
9	17	400
10	19/29	400
11	18/19	400
12	18/24	400
13	18/31	400
14	19/26	600
Shuma		7700

-Në hartën me nomenklaturë GJ; F- 7.

NR.	Pasuria nr,	Sipërfaqe m ² .
1	28/48	500
2	23/46	400
3	23/96	600
4	16/44	600
Shuma		2100

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në nenet 105-109, kreu I, pjesa e VI, të ligjit nr. 8485, datë 08.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 20.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kapitulli IV (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe të ndiqen rrugët ligjore, për kërkimin e shpërblimit të dëmit **në vlerën 14,071,908 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje: Anëtarët e Këshilli të Bashkisë kanë përfituar padrejtësisht shumën 1,217,578 lekë, veprim në kundërshtim me pikën 16, të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njërive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar,

për arsye se janë paguar për punë të pa kryer, mospjesëmarrje në mbledhje të këshillit për vitin 01.01.2013 deri më 31.07.2015.

Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **1,217,578 lekë**, sa përfituar më tepër nga 25 anëtarët e këshillit sipas listës nr. 3, bashkëlidhur.

2. Gjetje nga auditimi: Në transaksionin nr. 259, datë 06.08.2013, në vlerën 3,040,040 lekë, konstatojmë se:

-Nuk është zbatuar afati kohor për ekzekutimin e punimeve i cili në DST dhe ofertë është 5 muaj ose 14.03.2013.

-Nuk janë llogaritur dëmet për zbatim të vonuar të punimeve konformë kushteve të kontratës, në vlerën 5,608,357 lekë e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga operatori ekonomik "F..." shpk për arsye se, sipas procesverbalit të kolaudimit datë 15.11.2014 nënshkruar nga Ing. I.C në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, Ing. A. C në cilësinë e Kolaudatorit të punimeve dhe Sipërmarrësit, cilësohet se punimet në fakt kanë përfunduar më datë 20.11.2014 .

Rekomandim: Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **5,608,357 lekë**, nga OE "F..." sh.p.k e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penaliteteve, në tenderin me objekt "Ndërtim i rrugës: Unaza Granicë-Gerhot faza IV" .

3. Gjetje: Në transaksionin nr. 473, datë 11.11.2014, në vlerën 2,135,106 lekë, **konstatojmë se:**

-Nuk janë realizuar në afat punimet e zbatimit, pasi sipas dokumenteve të dosjes teknike procesverbali i punimeve që hiqen dhe shtohen është mbajtur më datë 01.10.2014, ndërsa në njoftimin e përfundimit të punimeve data e përfundimit të punimeve është 04.11.2014.

-Nuk ka amendim të afatit të punimeve datë 04.05.2013 me objekt "Ndërtim i rrugës: "Unaza Granicë - Gerhot faza IV", në vlerën 7,705,650 lekë pa t.v.sh dhe 9,246,780 lekë me t.v.sh me kohëzgjatje të kontratës 3 muaj nga data e lidhjes së saj.

-Nuk janë mbajtur penalitete për moskryerjen në kohë të punimeve të zbatimit në vlerën **2,835,679 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga Operatori Ekonomik "T.." .

Rekomandim: Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **2,835,679 lekë**, nga Operatori Ekonomik "T.." sh.p.k e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penaliteteve për 92 ditë vonesa, në tenderin me objekt "Ndërtim i rrugës: Unaza Granicë - Gerhot faza IV" .

4. Gjetje nga auditimi: Në transaksionin nr. 2631, datë 20.08.2014, në vlerën 2,143,200 lekë, rezultoi se:

- Mallrat nuk janë lëvruar në afat nga operatori ekonomik "Pr...", në kundërshtim me kushtet e përgjithshme të kontratës së mallrave dhe nuk janë aplikuar dëme për lëvrim të vonuar të mallrave në vlerë 402,320 lekë e llogaritur 1.880.000 leke pa TVSh -940000 lekë x 4/1000 x 45 ditë =169,200 lekë + 1,880,000 lekë-940000 lekë x4/1000 x 62 ditë =233,120 lekë .

Rekomandim: Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **402,320 lekë**, nga operatori ekonomik "Pr..." sh.p.k e cila përfaqëson

shumën e moszbatimit të penalteteve përkatësisht 45 dhe 62 ditë vonesa, në tenderin me objekt “Blerje kazanë metalik 1100 L për mbetjet urbane”.

5. Gjetje: Bashkia Gjirokastër si Autoriteti Kontraktor, ka kryer pagesa të tepërta në vlerën, **141,440 lekë** ndaj bashkimit të operatorëve ekonomik “A. A” sh.p.k.&”E...C” shpk, në situacionimin e volumeve të punimeve për një zë punimi me diferencë volumi të pa kryer, në objektin “Projekte në Parkun e Viroit: Sistemim i Parkut të Viroit, Rikonstruksion i rrugës në Parkun e Viroit, Ndriçim i trotuarit nga ana e qytetit”, Bashkia Gjirokastër, në kundërshtim me kushtet e kontratës së datës 22.07.2014 .

5.1.Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **141,440 lekë**, nga bashkimi i operatorëve ekonomik “A- A” sh.p.k.&”E.... Const...” shpk, paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Projekte në Parkun e Viroit: Sistemim i Parkut të Viroit, Rikonstruksion i rrugës në Parkun e Viroit, Ndriçim i trotuarit nga ana e qytetit”.

6. Gjetje: Në dosjen e dhënies së lejes së përdorimit me Nr. Prot., 2274/1, datë 11.11.2014 me objekt “Njësi tregtare +banesë 8+1 kate”, në lagjen “Pllaka” , u konstatua se: Sipas dokumentit datë 19.01.2005 të lëshuar nga bashkia Gjirokastër (Seksioni i Urbanistikës) kreu II. z. N.B ka paguar 366 m2 x 2500 lekë/m2 ose 915,000 lekë. Në fakt leja e ndërtimit është dhënë mbi një sipërfaqe totale të sheshit të ndërtimit 556 m2. Pra subjekti ka paguar më pak **në vlerën 475,000 lekë** .

6.1. Rekomandim: Bashkia Gjirokastër, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **475,000 lekë** nga z. N.B, diferencë e vlerës së trullit të papaguar sipas dokumentit datë 19.01.2005 të lëshuar nga Bashkia Gjirokastër (Seksioni i Urbanistikës) kreu II.

7, Gjetje nga auditimi: Në 29 raste vlera e ndërtimit të objektit nuk është llogaritur duke u bazuar në manualet teknike të çmimit të punimeve të ndërtimit sipas VKM-së përkatëse ose çmimit për m2 sipërfaqe ndërtimi sipas EKB-së. Duke ju referuar të dhënave të projektit dhe çmimit për m2 sipas EKB-së rezulton se, vlera e ndërtimit të objektit është më e lartë se ajo e përlllogaritur sipas preventivit, për rrjedhojë investitorët kanë paguar më pak për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifën për studime e projekte në vlerën **3,391,534 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga subjektet, sipas listës “Lejë përdorimi 2013”, dhe Leje përdorimi 2014 .

7.1. Rekomandim: Vlera prej **3,391,534 lekë**, nga kërkuesit e lejeve të përdorimit sipas Aneksit Nr.1, bashkëlidhur, për arsye se, vlera e ndërtimit të objektit sipas preventivit të paraqitur nuk është llogaritur, duke u bazuar në manualet teknike të çmimit të punimeve të ndërtimit të miratuara me VKM-në përkatëse ose çmimit për m2 sipërfaqe ndërtimi të përcaktuara nga EKB.

B.1. MASA PËR PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit në tenderat e zhvilluar, u konstatuan se në *7 kontrata* me vlerën 76,679,357 lekë në vitin 2014 dhe në 3 kontrata me vlerë 5,168,655 lekë në vitin 2015, ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, si dhe përdorimin me diferencë negative në fondet buxhetore në vlerën totale 12,195,169 lekë, veprime në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar .

1.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike, për 10 procedurat e prokurimeve me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **12,195,169 lekë**, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

C. MASA DISIPLINORE

C.1. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nënpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” sipas përgjegjësiave përkatëse, për këta persona:

1. z. V.M, me detyrë N /Kryetar i bashkisë për problemet me Infrastrukturën, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

2. zj, A.L, me detyrë Drejtor e Financës, Buxhetit dhe Pronave, në cilësinë e Kryetarit dhe anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

3. z. I.Ç, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës dhe Zhvillimit, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për arsye se:

KVO-ja ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e operatorëve pjesëmarrës. Konkretisht, ka s'kualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta OE, por këto mangësi lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe e ka shpallur fitues OE në kundërshtim me Neni 52, 53/1, 55, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu V pika 4, Kreu IX pika 1/ç.

Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1 që ka të bëjë, me mirëpërdorimin e fondeve publike, me kursimin e tyre dhe, me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke i bërë që vlera prej **12,195,169 lekë** nga e cila 11,101,202 lekë në 8 kontrata me vlerën 76,679,357 lekë në vitin 2014 dhe 1,093,967 lekë në 11 kontrata me vlerë 30,034,950 lekë, fonde buxhetore të mospërdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të buxhetit të shtetit.

C.2. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nënpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke marrë masë disiplinore “Vërejtje”, për këta persona:

4. z.E.L, me detyrë Inspektor i Kadastrës Urbane dhe Regjistri Elektronik Kombëtar, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

5. zj. A.C, me detyrë Inspektor Kontraktor dhe Arkivat, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

Për arsye se:

KVO-ja ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e operatorëve pjesëmarrës. Konkretisht, ka s'kualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta OE, por këto mangësi lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe e ka shpallur fitues OE në kundërshtim me Neni 52, 53/1, 55, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar Kreu V pika 4, Kreu IX pika 1/ç.

Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i sanksionuar në nenin 1 që ka të bëjë, me mirëpërdorimin e fondeve publike, me kursimin e tyre dhe, me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke i bërë **që vlera prej 12,195,169 lekë** nga e cila 11,101,202 lekë në 8 kontrata me vlerën 76,679,357 lekë në vitin 2014 dhe 1,093,967 lekë në 11 kontrata me vlerë 30,034,950 lekë, fonde buxhetore të mospërdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të buxhetit të shtetit.

6. z. S.G., me detyrë Inspektor Jurist, në cilësinë e Juristit në Njësinë e Prokurimit,

7. z.E.R., me detyrë Inspektor në Sektorin e Urbanistikës dhe Zhvillimit, në cilësinë e Specialistit të Njësisë së Prokurimeve,

8. z. H.Ç., me detyrë Drejtor në Drejtorinë Juridike e Prokurimeve QKR dhe QKL, në cilësinë e Specialistit të Njësisë së Prokurimeve,

9. zj. M.K., me detyrë Inspektore Prokurimeve, në cilësinë e Specialistit të Njësisë së Prokurimeve,

10. z. V.B., me detyrë Inspektor Urbanist Ligjor dhe Trashëgimisë, në cilësinë e Specialistit të Njësisë së Prokurimeve.

Për arsye se:

-Në përcaktimet dhe miratimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ka mangësi, pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomike më të favorshme nuk i plotësojnë kushtet e nenit 46, pikat 1, e LPP-së, sepse nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës; nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderave.

-Kriteret e përdorura për vlerësimin e ofertave nuk janë specifikuar në mënyrë të saktë nga ana e autoritetit kontraktor, për rrjedhojë lejojnë Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, t'i interpretojnë ato në mënyra të ndryshme në proceduar të ndryshme madje në disa raste me impakte financiar në dëm të autoritetit kontraktor.

11. z. A.P., me detyrë Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave Tatim-Taksave, Tarifave dhe Tregu me Shumicë.

12. z. A.P., me detyrë Inspektor për Planifikimin dhe Realizimin e të Ardhurave Vjetore.

13. z. B.L., me detyrë Inspektor i Përpunimit dhe Bashkërendimit në Terren,

14. z. L.S., me detyrë Inspektor të Terrenit,

15. z. M.B., me detyrë Inspektor të Terrenit,

16. z. V. V. M., me detyrë Inspektor të Terrenit,

17. z. M. B., me detyrë Inspektor të Terrenit,

18. z. M.B, me detyrë Inspektor të Terrenit.

Për arsye se:

- Në treguesit e programimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, sipas zërave të përcaktuara në programet përkatëse, për periudhën 07.07.2013-31.12.2013, 2014 dhe 01.01.2015- 31.07.2015 rezultoi një diferencë më pak **në vlerë 68,859 mijë lekë**, e cila ka ardhur kryesisht nga mos funksionimi i plotë i Drejtorisë së të Ardhurave (Tatim-Taksat), si dhe nga mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorive të bashkisë. Këto veprime bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 2, pika 1 dhe 5, neni 16 “Të ardhurat e veta të komunës dhe të bashkisë”, gërmat a, b, c dhe ç, kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, “Zbatimi i Sistemit Tatimor në Republikën e Shqipërisë”, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7, si dhe kërkesat e udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”, i ndryshuar.

-Subjektet me detyrime debitoare të papaguara për taksat dhe tarifatat nuk janë ndëshkuar me sanksione në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

-Detyrimet debitoare (borxhit), kanë ardhur çdo vit në rritje, të cilat më datë 31.07.2015 janë në vlerën **29,349 mijë lekë**, për arsye se masat shtrënguese, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e mallrave, pothuajse nuk janë zbatuar, veprim ky që bie ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 88, autoriteti dhe kompetencat për mbledhjen e detyrimit tatimor të paguar.

D. VLERËSIM AUDITIMI

Ky auditim në vlerësimin e bërë mbi plotësimin e Programit të Auditimit dhe zbatimit të standardeve, **vlerësohet si auditim i dobët** nga Kryetari, veçanërisht auditimi i procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave për investime, shërbime e blerje mallra, pjesë të konsiderueshme të këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit, do të riauditohen përsëri në një kohë të dytë.

Nga Bashkia Gjirokastrë, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi e zbatimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Shefki Jaupi, Mirosh Bogdo, Pirro Bregaj, Rezart Golemaj dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT